



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Letërsi e Gjuhës B (1)

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë, 20 orë leksion, 20 orë seminar

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Gjuhë angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva te përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri themelore dhe të strukturuar mbi zhvillimin kronologjik të letërsisë britanike nga periudha e hershme deri te romantizmi. Të nxisë ndërgjegjësimin kulturor dhe historik përmes studimit të konteksteve letrare dhe sociale të epokave të ndryshme. Të zhvillojë aftësinë e të menduarit kritik dhe interpretuar, përmes leximit dhe diskutimit të teksteve përfaqësuese.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohin dhe identifikojnë rrymat letrare dhe kulturore të periudhave kyçe si: letërsia e hershme britanike, mesjetare, elizabetiane, e shek. XVIII dhe romantike.
2. Të njohin autorët kryesorë dhe veprat përfaqësuese të secilës periudhë dhe të analizojnë stilin, temat dhe strukturën e tyre.
3. Të zhvillojnë aftësi për të lexuar kritikisht dhe për të diskutuar në mënyrë të argumentuar, duke krahasuar qasje dhe mesazhe letrare në kohë të ndryshme.

Rezultatet e pritshme:

1. Shpjegojnë zhvillimin e letërsisë britanike në mënyrë kronologjike dhe të identifikojnë tiparet kryesore të secilës periudhë letrare.
2. Analizojnë vepra të autorëve të njohur britanikë, duke përfshirë elemente stilistike, tematike dhe historiko-kulturore.
3. Shprehin qëndrime kritike dhe interpretime personale mbi tekstet letrare, duke demonstruar përvetësim të gjuhës, vokabularit letrar dhe njohuri të kontekstit kulturor.